

VENDIM
Nr. 216, datë 15.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 169, DATË 3.11.2020, “PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR, DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT, TË SHOQËRISË OST SHA”

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 91 dhe 92, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 16, pika 2, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 132/6 prot., datë 11.12.2020, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020,

konstatoi se:

- Bordin i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 3.11.2020, u shpreh në lidhje me kërkesën e OST sh.a. për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Vendimi i sipërcituar, i është dërguar për dijeni OST sh.a. në mënyre elektronike, më datë 11.11.2020, nëpërmjet komunikimit me *email*, me qëllim njohjen me përmbajtjen përfundimtare të këtij dokumenti.

- OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 6567 prot., datë 18.11.2020, ka parashtruar në ERE kërkesën për rishikim të vendimit nr. 169, datë 3.11.2020, “Mbi kërkesën e OST sh.a. për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, ku ndër të tjera parashtron:

- OST sh.a. shpreh gatishmërinë e saj të plotë për të plotësuar, në kohë dhe në koordinim me stafin e ERE-s, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në një vendimmarrje nga ana juaj, në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit (të parashikuara në nenet 12 dhe 14, të Kodit të Procedurave Administrative).

- ERE kërkoi nga OST sh.a. informacionin shtesë dhe dokumentacionin e pretenduar në shkresën e sipërcituar. Në të njëjtën kohë është përgatitur shkresa përkatëse për OST sh.a. ku ndër të tjera i kërkohet, si më poshtë vijon:

- të bëj me dije fazën aktuale në të cilën është përgatitja e këtij udhëzuesi, i cili do të përfshijë të gjithë komponentët e nevojshëm të llogaritjes kosto – përfitim; nëse është përgatitur ndonjë draft konkret i udhëzuesit dhe nëse ka një draft konkret të këtij udhëzuesi, ky draft të përcillet në ERE;

- për të evidentuar nëse janë zbatuar përcaktimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 194, datë 3.12.2019, dhe ato të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, kërkohet të bëhet me dije nëse janë hapur llogari të ndara për aktivitetin komercial të fibrës optike. Nëse këto llogari janë hapur, periudhën kur janë hapur, si dhe gjendjen e tyre;

- OST sh.a. parashtron se janë realizuar analiza për planin e investimeve për vitin 2020. Analizat e përmendura nuk janë përcjell nga OST sh.a. në ERE në momentin e paraqitjes për miratim, si dhe në periudhën në vijim gjatë shqyrtimit të këtij plani. Në këto kushte kërkohet që OST sh.a. të përcjellë në ERE analizat e përmendura në shkresën e sipërcituar, për elementët të cilët përfshihen në planin e investimeve të OST sh.a., për vitin 2020;

- të bëjë me dije nëse detyrimet ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhen me aktivizimin e mekanizmit të garancisë sovrane për pagesat e kredive të marra nga institucionet ndërkombëtare apo janë detyrime të tjera. Në këtë kontekst, përcaktimet e VKM-së nr. 253, datë 24.4.2019, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik”, duhet të vlerësohen se cilat janë arsyet e aktivizimit të mekanizmit të garancisë sovrane për të paguar kreditë në institucionet ndërkombëtare nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit dhe jo nëpërmjet fondeve të vetë OST sh.a.;

- lidhur me sa parashtruar nga OST sh.a., mbi hartimin e masterplanit të zhvillimit, aktualisht jemi në muajin dhjetor 2020, kërkohet të bëhet me dije statusi i masterplanit nëse është hartuar një draft i tillë nga konsulenca dhe nëse OST sh.a. e disponon një draft të tillë mund ta përcjellë në ERE si një draft paraprak të masterplanit të zhvillimit të rrjetit;

- duke marrë në konsideratë faktin se OST sh.a., me shkresën nr. 6567 prot., datë 18.11.2020, shprehet e gatshme të përcjellë informacionin në ERE dhe për sa kërkuar me tonën nr. 993/3 prot., datë 24.9.2020, në këto kushte kërkohet të përcillet në ERE informacioni i kërkuar me tonën nr. 993/3 prot., datë 24.9.2020;

- në përfundim, i gjithë dokumentacioni i kërkuar në shkresën e ERE-s, si dhe çdo informacion ose analizë që OST sh.a. disponon për këtë qëllim, të përcillet në ERE, brenda 7 (shtatë) ditëve, në mënyrë që ERE të mund të vlerësojë sa kërkuar nga OST sh.a. me shkresën nr. 6567 prot., datë 18.11.2020.

- Për të analizuar të gjithë elementët e cituar më sipër, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., ERE-s i duhet më tepër kohë për të gjykuar dhe vlerësuar gjithë parashtrimet e bëra dhe të kërkuara nga OST sh.a., me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje, si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti